



01Nr.60/01-17846/23
Kačanik,31.07.2023

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 18 të Ligjit nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 18 të Rregullores 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, në bazë të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës , Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e vet të mbajtur me 31 korrik 2023, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01Nr.60/01-33331/22 ,TË DATËS 29.12.2022 -PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01NR.104/02-19963 TË DATËS 02.09.2022- PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE PËR PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Kuvendit të komunës 01Nr.60/01-33331/22, i datës 29.12.2022.

2. Ndryshim plotësimi i Vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet në pikën 3 , paragrafi 1, ashtu që:

2.1. Nga komisioni i ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës hiqet anëtarja nga Ekzekutivi i komunës -Arbnora Kuka.

2.2. Për anëtarë të këtij komisioni nga Ekzekutivi i komunës caktohet Kaltrina Çaka-Guri.

3. Me ndryshimet si në pikën 2 të këtij Vendimi, Komisioni i ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës , do të ketë këtë përbërje:

1. Kaltrina Çaka Guri- anëtare nga Ekzekutivi;
2. Fadil Guri- anëtar nga Ekzekutivi;
3. Hamide Luma- anëtare nga Kuvendi;
4. Adnan Reka- anëtar nga Kuvendi; dhe
5. Naim Hysa- anëtar nga Shoqëria civile.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset : Kryetari i komunës , Drejtorja për Urbanizëm ,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i komunës, Komisioni i ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës ,Arbnora Kuka ,Kaltrina Çaka -Guri, Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit

Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-33331/22
Kaçanik, 29.12.2022

Në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008) të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-092 -për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 prill 2019), të nenit 18 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës përmes DUKMM 01Nr. 60/01-33331/22, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 dhjetor 2022, mori:

VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 01NR. 104/02-19963 TË DATËS 02.09.2022 PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE PËR PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTEZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim, Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01nr. 104/02-19963.22 i datës 09.09.2022- për formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
2. Ndryshim Plotësimet e vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet të pika 2 e vendimit, paragrafi 1 dhe 3, ashtu që:
 - 2.1. Nga Komisioni i ankesave, hiqen: 1.Zekir Selimi anëtar i komisionit nga Ekzekutivi i Komunës -për shkak të vdekjes së tij. 2. Brahim Imishti – anëtar i komisionit nga Kuvendi i Komunës -me pajtimin e tij, për shkak të balancimit gjinor të komisionit.
 - 2.2. Për anëtarë të komisionit caktohen: Arbnora Kuka nga Ekzekutivi i Komunës dhe Hamide Luma nga Kuvendi i Komunës.
3. Me ndryshimet e bëra, Komisioni i ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ka këtë përbërje:
 1. Arbnora Kuka- anëtare (Ekzekutivi);
 2. Fadil Guri - anëtar (Ekzekutivi);
 3. Hamide Luma- anëtare (Kuvendi);
 4. Adnan Reka - anëtar (Kuvendi);
 5. Naim Hysa - anëtar (Shoqëria Civile).
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Komisioni; Brahim Imishti, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit; Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

